

**Lehtësirat për prodhuesit vendor
të prekur nga pandemia COVID-19**

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) përmes publikimit periodik të Buletineve të Rimëkëmbjes, i shpalosë më të rejat rreth Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Këto Buletine kanë për qëllim që përmes informatave që i ofrojmë qytetarëve të Kosovës, me nje gjuhë dhe terminologji sa më të thjeshtë të i shpalosë elementet kryesore të Ligjit të Rimëkëmbjes dhe Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike për pandeminë COVID-19. Kjo në mënyrë që çdoherë e më shumë të rritet transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve të Kosovës.

Ky edicion i Buletineve shpalosë temën e lirit të prodhuesve vendorë nga TVSH sipas Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID-19, sidhe përparësitë që u jepen prodhuesve të produkteve dhe shërbimeve vendore përgjatë periudhës së pandemisë COVID-19.



Lirimi i transaksioneve të sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore nga TVSH dhe Pakoja e Rimëkëmbjes

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike përmes nenit Neni 6 - Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka përfshirë mbështetjen e prodhuesve vendorë. Përmes këtij neni, Qeveria ofron përkrahje për prodhuesit vendorë me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të vendit e cila pësoi rënie nga pandemia COVID – 19 duke larguar kështu TVSH-në për transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore në Kosovë. Ky nen thekson:

2. Neni 28 i LTVSH-së, pas nën-paragrafit 1.12. shtohet një nën-paragraf i ri, me numër rendor 1.13., me teks si në vijim:

1.13. transaksionet e sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore bazuar në kriteret që përcaktohen me vendim nga Ministri i Bujqësisë. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministri i Financave me vendim përcakton procedurat dhe kriteret.”

Përmes këtij neni, Qeveria e Kosovës sqaron se të gjithë personat e regjistruar për të paguar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), për transaksionet e sigurimit dhe ato të ri-sigurimit në bujqësi, sidhe për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore që kultivohen në Kosovë nuk do të aplikohet TVSH për ta. Kjo mundësi mund të shfrytëzohet me kusht që të kenë plotësuar kriteret të cilat janë përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë.



Duhet theksuar gjithashtu se të gjithë personat e tatueshëm të cilët janë të regjistruar për TVSH, nuk e gëzojnë të drejtën e zbritjes së TVSH për disa nga përdorimet.

Ato janë:

- Blerjet e mallërave dhe shërbimeve, të cilat i përdorë për qëllim të realizimit të transaksioneve të sigurimit dhe ri-sigurimit në bujqësi, dhe
- Për policat e sigurimeve bujqësore për kulturat bujqësore

Të gjithë personat të cilët kanë të drejtë të aplikojnë për lirimin e transaksioneve nga TVSH, kjo masë vlenë nga data 01/12/2020 deri më 31/12/2021. Pas kësaj date, këto furnizime do të vazhdojnë të taten sipas normave të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Në kuadër të masave të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, në mënyrë që të u ofrohet ndihmë edhe prodhuesve vendorë, Qeveria e Kosovës i ka përfshirë nenin 13 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky nen parasheh përparësinë e prodhuesve të produkteve gjatë vlerësimit të ofertave. Sipas këtij neni:

Neni 13

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurorim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068

Përparësitë për prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore përgjatë pandemisë COVID-19


1. Gjatë vlerësimit të ofertave, të cilat janë dorëzuar nga prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore, kontratave të furnizimit për punë apo ofertuesve vendor, që në ofertë përmbajnë vetëm produkte dhe shërbime vendore, do t'i jepet përparësi krahas ofertave të ofertuesve me produkte dhe shërbime të huaja, në rast se diferenca në mes të këtyre ofertave nuk është më e lartë se dhjetë pikë.

2. Në rast se kriteri për dhënie të kontratës është çmimi i ulët, atëherë i jepet preferencë ofertuesit vendorë me produkte dhe shërbime vendore, në rast se çmimi i po të njëjtës nuk është më i lartë se pesëmbëdhjetë përqind në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.

Pra, sipas këtij neni, prodhuesit dhe shërbimet vendore do kenë përparësi ndaj ofertuesve të jashtëm gjatë vlerësimit të ofertave për produkte dhe shërbime të ndryshme. Kjo masë do të zbatohet për të gjithë gjatë vlerësimit të ofertave të cilat dorëzohen nga prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore të cilat në ofertat e tyre kanë produkte dhe shërbime vendore, nëse diferenca në mes tyre dhe ofertuesve të huaj nuk është më e madhe se 10 pikë.

Gjithashtu, preferencë do u jepet prodhuesve vendorë edhe në rastet kur kriteret për dhënien e kontratës kanë çmim më të ulët. Kjo masë zbatohet në rastet kur çmimi i ofertuar nga prodhuesit vendorë për produkte dhe shërbime nuk e arrinë shumën prej pesëmbëdhjetë përqind (15%) në krahasim me ofertat e pranura nga prodhuesit të cilët i prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre.

**Përparësi për prodhuesit
e produkteve dhe
shërbimeve vendore**



Lirimi nga TVSH i lëndës së parë dhe Rimëkëmbja Ekonomike

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike si instrument politik me rëndësi ka miratuar edhe lirim nga TVSH të lëndës së parë të prodhuar në Kosovë pavarësisht se a do të transportohet apo jo jashtë vendit. Kjo masë do të ndihmojë prodhuesit që të lirohen nga barra e pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për të gjithë lëndën e parë që prodhohet në vend. Si rezultat i kësaj mase, pritet që të rritet sasia e produkteve dhe shërbimeve vendore.

Në Kapitullin X i cili është emërtuar si “lirimet në eksportim”, në nenin 31, paragrafin 1., të Ligjit Nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, pas nën-paragrafit 1.5., shtohet nën-paragrafi i ri 1.6., me tekst si vijon:

1.6. Lënda e parë e cila prodhohet nga veprimtaritë biznesore të regjistruara dhe aktive në Republikën e Kosovës, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit apo jo, lirohet nga TVSH.”

Kjo masë padyshim se do të krijojë lehtësira për prodhuesit të cilët edhe gjatë kohës së pandemisë janë detyruar të paguajnë TVSH për të gjithë lëndën e parë.

Lirimet nga TVSH janë të përcaktuara përmes dokumenteve të nevojshme dhe do të u lejohet vetëm bizneseve të cilat zhvillojnë aktivitet prodhues në vendin tonë. Mirëpo, në mënyrë që të jenë përfitues nga ky lirim, biznesi prodhues duhet të parashtrojë kërkesë në Administratë Tatimore të Kosovës (ATK), gjegjësisht në Komisionin për lirim nga TVSH të lëndës së parë.

Kërkesa duhet të përfshijë:

• Aplikacionin për lirim nga TVSH

• Çertifikatën e regjistrimit të biznesit me informata mbi veprimtarinë e prodhimit

• Çertifikatën e regjistrimit të TVSH (nëse është Deklarues i TVSH)

• Planin vjetor të prodhimit

• Normativin me specifikat për secilin elemnt që përdoret në procesin e prodhimit duke identifikuar produktin final me specifikat teknike të tij, etj. Për çdo ndryshim në lidhje me normativin duhet të njoftohet Komisioni përkatës në ATK.

Kërkesa e kompletuar me dokumentet e kërkuara duhet për lirim nga TVSH me rastin e blerjes së lëndës së parë brenda vendit, duhet të dorëzohet në Zyrën Qendrore të ATK-së, dhe duhet drejtuar Komisionit përkatës. Administrata Tatimore (ATK) do të shqyrtojë dhe nxjerrë vendim për kërkesën e aplikuesit brenda pesëmbëdhjetë ditëve (15) nga data e pranimit të saj. Në rast se kërkesa i refuzohet atij biznesi, tatimpaguesi ka të drejtën e ankesës sipas Ligjit Nr. 03/L-222 - për Administratë Tatimore dhe Procedurat.

Sa i përket prodhuesve me rastin e blerjes së lëndës së parë, vendimin të cilin e ka marrur nga ATK, duhet ta prezantojë tek shitësi. Furnizuesi gjithashtu duhet që ta posedojë një kopje të vendimit të lëshuar nga ATK, të cilën duhet bashkangjitur në faturën e lëshuar për blerësin e mallit. Bazuar në vendimin e aprovimit për lirim nga TVSH, furnizuesi do të lirojë mallërat nga TVSH me rastin e shitjes së tyre për prodhuesin. Për të aplikuar për Lirim nga TVSH për lëndën e praë, ju duhet të shkakroni edhe formularin i cili mund të gjendet këtu:

<https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2020/12/Aplikacioni-per-Lirimet-nga-TVSH.pdf>

Aplikimi përmbanë kërkesa për informata të detajuara rreth aplikuesit. Në këtë aplikacion kërkohen që në fillim informatat e përgjithshme rreth aplikuesit, pastaj kërkohet që të bëhet një përshkrim i veprimtarisë afariste sidhe kodet e regjistrimit. Ky aplikim përmbanë edhe kërkesa për infomata rreth përshkrimit të saktë të mallërave, normativeës së prodhimit dhe planit vjetor të prodhimit.

Faqja e parë e aplikacionit ka këto informata:



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Data: _____

TVSH - BV

Formulari i Aplikacionit për “Lirimet nga TVSH në rastin e blerjes së lëndës së parë brenda vendit”

Sqarim:

Ky aplikacion është i bazuar në Ligjin për TVSH nr. 05/L-037, nenit 31, paragrafi 1, Neni 7 i Ligjit Nr.07-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVIT 19, Paragrafi 3, Vendimi Shpjegues 01/2020, Lënda e parë e cila prodhohet nga veprimtaritë biznesore të regjistruara dhe aktive në Republikën e Kosovës, pavarësisht a eksportohet jashtë vendit apo jo, lirihihet nga TVSH. Lirimi do të lejohet vetëm për bizneset të cilat zhvillojnë aktivitetet prodhues.

Më qëllim të përfutimit nga ky lirim, tatimpaguesi duhet të parashtoj këtë kërkesë- aplikacion pranë Administratës Tatimore të Kosovës sipas Neni 7 i Ligjit Nr.07-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike COVIT 19, Vendimit Shpjegues 01/2020, për mallrat e blera të cilat do të hyjnë në prodhim dhe do të transformohen në produkte finale.

Tatimpaguesi si aplikues me këtë formularë bartë përgjegjësinë e plotë ligjore mbi saktësinë dhe korrektësinë e deklaratës së tij të plotësuar në këtë aplikacion dhe për dokumentet e bashkangjitura sipas kërkesave ligjore të lartpërmendura. Nëse, nga Organet Tatimore pas blerjes së mallit konstatohet se, mallrat e blera brenda vendi si “lëndë e parë” nga tatimpaguesi nuk janë përdorur për qëllime prodhuese sipas dispozitave ligjore dhe akteve tjera nënligjore të lartpërmendura, por për qëllime tjera, si ato tregtare, të rishijes etj., atëherë ATK do të ngarkon detyrimet tatimore me të gjitha ndëshkimet dhe intereset.

Aplikacioni dorëzohet:

- Për herë të parë
 Shtesë
 Korrigjim

Informatat e përgjithshme mbi aplikuesin:

Emri i Tatimpaguesit:

NUI:

Adresa e plotë:

Numri i telefonit:

E-mail adresa:

Pronari/Menaxheri:

Emri i Tatimpaguesit:	
NUI:	
Adresa e plotë:	
Numri i telefonit:	
E-mail adresa:	
Pronari/Menaxheri:	


Ndikimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike ne zhvillimin ekonomik të vendit në TM1 2021

Se kanë filluar të ndikojnë masat e Pakos së Rimëkëmbjes, sidomos mund të vërehet ndikimi i këtyre masave të sipërpërmendura, mund ta ilustrojnë edhe raportet e nxjerra nga Agjencia Statistikore e Kosovës gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të vitit 2021. Bazuar në të dhënat e publikuara nga Agjencia Statistikore e Kosovës, eksporti i mallrave në muajin mars 2021 kishte vlerën 61.8 milionë Euro, ndërsa importi 382.5 milionë Euro, që është një rritje prej 92.2% për eksport dhe 51.8% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Table 1. Të dhënat lidhur me krahasimin e eksportit dhe importit gjatë TM1 të vitit 2020-2021

Muaji	Eksport 2020	Import 2020	Eksport 2021 (%)	Import 2021 (%)
Janar	28,9 mil	221,2 mil	42,5 mil	235,8 mil
Shkurt	35,9 mil	263.3 mil	48,4 mil	301,7 mil
Mars	32,1 mil	252.0 mil	61.8 mil	382.5 mil

Të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për TM1 2020-2021



Në bazë të kësaj tablele, mund të theksojmë se ekonomia e vendit ka filluar rimëkëmbjen e saj dhe se duke pasur parasysh se krahasimet e vlerave të eksportit dhe importit brenda periudhës 2020-2021, vërejmë se jemi duke vazhduar drejt rimëkëmbjes së suksesshme. Edhe pse kjo pako është pakoja e parë që ka për qëllim Rimëkëmbjen ekonomike, ne presim që hisedarët e Kosovës të hartojnë pakos e rradhës të cilat do ndihmojnë në rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit e cila pësoi rënie gjatë kohës kur vendi ynë sikurse shumica e vendeve të botës po përballej me pandeminë COVID-19.

06

BULETINI I RIMËKËMBJES

prill 2021



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të hapur (KFOS).